

Platforma për të Drejtat e Njeriut

Constitutional Articles: Të Drejtat e Fëmijës

Constitutional Paragraph: 50 para 5

Secili fëmijë gëzon të drejtën për raporte të rregullta personale dhe kontakte të drejtpërdrejta me prindërit e vet, me përjashtim kur institucioni kompetent përcakton se një gjë e tillë është në kundërshtim me interesat më të mira të fëmijës.

Instrumentet ndërkombëtare

Nenet

Konventa për
Eliminimin e të gjitha
Formave të
Diskriminimit ndaj
Gruas

Neni 5 (b)

Konventa për
Eliminimin e të gjitha
Formave të
Diskriminimit ndaj
Gruas

Neni 5

Shtetet palë marrin të gjitha masat e përshtatshme:

(b) Për të siguruar që edukimi i familjes të përfshijë të kuptuarit e duhur të maternitetit si një funksion social dhe të njohjes së përgjegjësisë së përbashkët të burrit dhe të gruas në edukimin dhe zhvillimin e fëmijëve të tyre duke bërë të qartë se interesi i fëmijëve është kusht kryesor në të gjitha rastet.

Pakti Nderkombëtar
për të Drejtat civile
dhe Politike
Pakti Nderkombëtar
për të Drejtat civile
dhe Politike

Neni 23.4

4. Shtetet palë të këtij Pakti marrin masa të përshtatshme për të siguruar barazinë e të drejtave dhe të përgjegjësisë të bashkëshortëve lidhur me martesën, gjatë martesës dhe me rastin e prishjes së saj. Në rastet e prishjes së martesës, do të merren masa me qëllim që fëmijëve t'u sigurohet mbrojtja e nevojshme.

**Instrumentet
ndërkombëtare**

Konventa për të
Drejtat e Fëmijës
Konventa për të
Drejtat e Fëmijës

Konventa për të
Drejtat e Fëmijës
Konventa për të
Drejtat e Fëmijës

Ligjet

Nenet

Neni 9 (3 & 4)

3. Shtetet Palë respektojnë të drejtën e fëmijës së ndarë nga njëri ose nga të dy prindërit, që të mbajë rregullisht marrëdhënie vetjake dhe takime të drejtpërdrejta me të dy prindërit e tij, me përjashtim të rasteve kur kjo nuk është në interesin më të lartë të fëmijës.

4. Kur ndarja është rrjedhojë e çdo mase të marrë nga një Shtet Palë, si ndalimi, burgimi, internimi, dëbimi ose vdekja, (përfshirë këtu vdekjen për çfarëdo shkak, kur personi është i ndaluar nga shteti) e njërit ose të dy prindërve, ose të fëmijës, ky Shtet Palë, sipas kërkesës, u jep prindërve, fëmijës ose, kur është rasti, një anëtar tjetër të familjes, të dhëna të hollësishme mbi vendin ku ndodhen anëtarit ose anëtarët e familjes, me përjashtim të rasteve kur dhënia e këtyre të dhënave dëmton mirëqenien e fëmijës. Shtetet Palë sigurojnë gjithashtu, që paraqitja e një kërkesë të tillë të mos sjellë në vetvete pasoja të dëmshme për personin ose personat e interesuar.

Neni 10 (2)

2. Një fëmijë, prindërit e të cilit banojnë në shtete të ndryshme, ka të drejtë të mbajë marrëdhënie personale dhe takime të rregullta të drejtpërdrejta me të dy prindërit e tij, me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme. Për këtë qëllim dhe në përputhje me detyrimin e Shteteve Palë, sipas paragrafit 1 të nenit 9, Shtetet Palë respektojnë të drejtën e fëmijës dhe të prindërve të tij për t'u larguar nga çdo vend, përfshirë këtu edhe të vetin, si dhe të kthehen në vendin e tyre. E drejta për t'u larguar nga çdo vend bëhet objekt kufizimesh vetëm në rastet e përcaktuara me ligj, të cilat janë të nevojshme për të mbrojtur sigurimin kombëtar, rendin publik, shëndetin dhe moralin publik ose të drejtat dhe liritë e të tjerëve dhe që janë në pajtim me të drejtat e njohura në këtë Konventë.

Nenet

Mbrojta Institucionale e të drejtave

Ligji nr. 2004/32 për familjen i Kosovës dhe LIGJI NR.

06/L-077 PËR
NDRYSHIMIN DHE
PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.
2004/32 PËR FAMILJEN I
KOSOVËS

Ligji nr. 2004/32 për familjen i Kosovës dhe LIGJI NR.

06/L-077 PËR
NDRYSHIMIN DHE
PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.
2004/32 PËR FAMILJEN I
KOSOVËS

(1) Punët e mbrojtjes dhe të ndihmës familjare do t'i ushtron organi kompetent i administratës komunale i cili është kompetent për punët e mbrojtjes sociale.

(2) Organi i Kujdestarisë është një organ komunal administrative kompetent për çështje sociale. Ai përbëhet nga një grup i ekspertëve me përvojë profesionale në fushën e veçantë të përgjegjësisë.

(3) Organi i Kujdestarisë mundet gjithashtu të jetë organ (grup i ekspertëve siç është cekur më lart) i veçantë i institucionit social i themeluar nga Kuvendi Komunal për të kryer detyrat e tilla.

(4) Organi i Kujdestarisë pjesëmarrës në procedurë është i autorizuar të bëjë propozime për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të fëmijëve, të paraqes fakte të cilat nuk janë përfshirë, të propozojë administrimin e provave të domosdoshme, të ushtrojë mjetet juridike dhe të

ndërmerr veprime tjera gjyqësore. Gjykata është e obliguar të ftojë në gjyq Organin e Kujdestarisë pjesëmarrës në procedurë në të gjitha seancat gjyqësore dhe t'i dorëzojë atij të gjitha vendimet.

Ligji nr. 2004/32 për familjen i Kosovës dhe LIGJI NR.

06/L-077 PËR
NDRYSHIMIN DHE
PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.
2004/32 PËR FAMILJEN I
KOSOVËS

Ligji nr. 2004/32 për familjen i Kosovës dhe LIGJI NR.

06/L-077 PËR
NDRYSHIMIN DHE
PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.
2004/32 PËR FAMILJEN I
KOSOVËS

Neni 147

Masat urgjente të Organit të Kujdestarisë

(1) Nëse Organi i Kujdestarisë mëson për rrezikun ekzistues për fëmijun për shkak të abuzimit të të drejtës prindërore ose çfarëdo rreziku për fëmijën nga neglizhenca serioze e detyrave prindërore, është i detyruar që urgjentisht të ndërmerr masa për mbrojtjen e personalitetit, të drejtave dhe interesave të fëmijës.

(2) Ofiqari ka për detyrë që të lajmërojë Organin e Kujdestarisë për lindjen e fëmijës, njëri ose të dy prindërit e të cilit janë të panjohur, si dhe për marrjen e masave të domosdoshme për mbrojtjen e tij.

Marrja e fëmijës nga kujdesi i prindërve

Ligji nr. 2004/32 për familjen
i Kosovës dhe LIGJI NR.
06/L-077 PËR
NDRYSHIMIN DHE
PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.
2004/32 PËR FAMILJEN I
KOSOVËS
Ligji nr. 2004/32 për familjen
i Kosovës dhe LIGJI NR.
06/L-077 PËR
NDRYSHIMIN DHE
PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.
2004/32 PËR FAMILJEN I
KOSOVËS

(1) Fëmija nuk do të largohet nga kujdesi i prindit/prindërve të tij/saj ose të kujdestarit të tij ligjor pa lejen e tyre apo pa urdhër të gjykatës.

(2) Përjashtimisht, kur organi i kujdestarisë ka arsye të bazuar për të besuar se ekziston rrezik serioz i drejtpërdrejtë për shëndetin, sigurinë apo mirëqenien e fëmijës, organi i kujdestarisë mund të hyjë në cilin do vend dhe të largojë fëmijën në një vend të sigurt, ku ai/ajo do të ketë

përkujdesje për një periudhë që nuk kalon 72 orë.

(3) Para se të skadojë afati prej 72 orëve, organi i kujdestarisë rastin duhet ta paraqesë në gjykatën kompetente, e cila vendos për kujdestarinë e fëmijës. Nëse e kërkojnë rrethanat, gjykata mund të jep urdhër për vlerësim për një periudhë 21 ditësh, për të mundësuar hetime

të mëtutjeshme dhe vlerësime, deri në të cilën kohë çështja duhet të paraqet në gjykatë për shqyrtim të mëtejshëm.

(4) Me këtë marrje të fëmijës nuk pushojnë të drejtat e tjera që u takojnë prindërve, as detyrate tyre ndaj fëmijës.

Ndarja e fëmijës nga familja

1. Fëmija nuk do të largohet nga kujdesi i prindit/prindërve të tij ose të kujdestarit të tij ligjor pa lejen e tyre apo pa urdhër të gjykatës.
2. Përrjashtimisht, kur organi i kujdestarisë ka arsye të bazuar për të besuar se ekziston rrezik serioz i drejtpërdrejtë për shëndetin, sigurinë apo mirëqenien e fëmijës, organi i kujdestarisë mund të hyjë në cilindo vend dhe të largojë fëmijën në një vend të sigurt, ku ai/ajo do të ketë përkujdesje për një periudhë që nuk kalon shtatëdhjetë e dy (72) orë.
3. Para se të skadojë afati prej shtatëdhjetë e dy (72) orëve, organi i kujdestarisë rastin duhet ta paraqesë në gjykatën kompetente, e cila vendos për kujdestarinë e fëmijës. Nëse e kërkojnë rrethanat, gjykata mund të jep urdhër për vlerësim për një periudhë njëzet e një (21) ditëshe, për të mundësuar hetime të mëtutjeshme dhe vlerësime deri në kohë kur çështja duhet të paraqitet në gjykatë për shqyrtim të mëtejshëm.
4. Fëmija nuk mund të ndahet nga prindërit, kujdestari i tij kundër dëshirës dhe vullnetit të tij, përveç se në rastet nëse kjo ndarje është në interesin më të mirë të fëmijës, nëse fëmija është në rrezik dhe nëse kjo ndarje është e pashmangshme dhe nëse kjo ndarje kërkohet nga ligji ose nga një vendim i gjykatës i formës së prerë. Nëse fëmija ndahet nga prindërit, kujdestari i tij, pikëpamjet dhe dëshirat e fëmijës duhet të dëgjohen, konsiderohen dhe dokumentohen në dokumentacionin që hartohet për këtë qëllim. Pikëpamjet e fëmijës duhet të dëgjohen dhe dokumentohen nga shërbimet sociale ose gjykata.
5. Në të gjitha procedurat në pajtim me paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni, të gjitha palët e interesuara duhet të kenë mundësi që të marrin pjesë në procedurë dhe të bëjnë të njohura mendimet e tyre.
6. Fëmija që është i ndarë nga njëri ose të dy prindërit ka të drejtë që të mbajë lidhje personale dhe takime të drejtpërdrejta, të rregullta me të dy prindërit, me përjashtim të rasteve kur kjo nuk është në interesin më të mirë të fëmijës.
7. Kur ndarja është rrjedhojë e çdo mase të marrë nga institucionet kompetente, si ndalimi, burgimi, internimi, dëbimi ose vdekja, (përfshirë këtu vdekjen për çfarëdo shkak, kur personi është i ndaluar nga institucionet kompetente) e njërit ose të dy prindërve, ose të fëmijës, sipas kërkesës institucioni u jep prindërve, fëmijës ose kur është rasti një anëtar tjetër të familjes të dhëna të hollësishme mbi vendin ku ndodhet anëtarit ose anëtarët e familjes, me përjashtim të rasteve kur dhënia e këtyre të dhënave dëmton mirëqenien e fëmijës. Duke siguruar që paraqitja e një kërkesë të tillë të mos sjellë në vetvete pasoja të dëmshme për personin ose personat e interesuar.
8. Vendimi për vendosjen e fëmijës në kujdes alternativ, zbatohet, monitorohet dhe raportohet nga Qendra për Punë Sociale dhe rishikohen rregullisht siç parashihet me legjislacion në fuqi ose me vendim të gjykatës.

LIGJI NR. 06/L-084 PËR
MBROJTJEN E FËMIJËS
LIGJI NR. 06/L-084 PËR
MBROJTJEN E FËMIJËS

decisionTitle***decisionDescription***

Rasti K. dhe T. k.
FINLANDES
(Aplikimi no.
25702/94) 12/07/2001

Rasti filloi nga një kërkesë (nr. 25702/94) kundër Republikës së Finlandës të paraqitur pranë Komisionit Evropian të të Drejtave të Njeriut ("Komisioni") sipas ish-nenit 25 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ("Konventa") nga dy shtetas finlandezë, K. dhe T. ("aplikantët"), më 26 tetor 1994.

Parashtruesit fillimisht pretenduan se faktet e çështjes zbuluan një shkelje nga shteti i paditur për detyrimet e tij në bazë të neneve 5, 6 3 (c), 8, 10 dhe 12 të Konventës të marra vetëm ose në lidhje me nenin 13. Gjykata vendosi se ka pasur një shkelje të nenit 8 të Konventës në lidhje me urdhrin e kujdesit urgjent në lidhje me J. Gjykata unanimisht vendosi se ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventës për shkak të mos marrjes së hapave të duhur për ribashkohen familjen.